

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6241  
E martë, 16 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

Pas rezultatit të dobët të  
LDK-së në zgjedhje,  
Mustafa ofron dorëheqje



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

REZULTATET PRELIMINARE NXJERRIN FITUESE TË ZGJEDHJEVE TË  
14 SHKURTIT, LËVIZJEN VETËVENDOSJE

## HUMBËSIT PRANOJNË REZULTATIN, UROJNË VETËVENDOSJEN

OPINION

KOHA E VETËVENDOSJES  
ERDHI NË ÇASTIN E DUHUR.  
SFIDA E VËRTETË PËR ALBIN  
KURTIN DHE EKIPIN  
E TIJ NIS TANI F. 11

Nga Bedri  
ISLAMI



AKTUALE



BE-ja: TË VAZHDOJË DIALOGU  
ME SERBINË F. 5

NJË I VDEKUR DHE 178 RASTE TË  
REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

AKTUALE

PËRFAQËSUESIT E BIZNESEVE  
BËJNË THIRRJE PËR  
KRIJIMIN SA MË SHPEJT  
TË QEVERISË SË RE F. 9

MBAHET TAKIMI FILLESTAR I  
MENAXHMENTIT TË LARTË TË  
ATK-së ME FMN-në F. 9



SPORT

DY NDESHJET E SUPERLIGËS  
PËRFUNDOJNË BARAS F. 12

Rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë nxjerrë Lëvizjen Vetëvendosje fituese të zgjedhjeve parlamentare me 48 për qind të votave. Subjektet politike që kanë humbur zgjedhjet e 14 shkurtit kanë pranuar rezultatin dhe kanë uruar fituesin për fitoren më të thellë në historinë politike të Kosovës. Në bazë të mbi 99.20 për qind të votave të numëruara nga KQZ-ja, partia e dytë është renditur PDK-ja me 17 për qind, pasuar nga LDK-ja me 13 për qind dhe AAK-ja me 7 për qind dhe Nisma me mbi 2 për qind, e cila nuk e kalon pragun zgjedhor



## SAHITI: UP-ja VAZHDON TË KETË ROL PRIJËS NË LËVIZJET SHOQËRORE PËR DEMOKRATIZIM



Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka thënë se UP-ja vazhdon të ketë rol prijës në lëvizjet shoqërore për demokratizim, zhvillim dhe qëndrueshmëri. Në 51-vjetorin e themelimit të UP-së, rektori Sahiti ka theksuar se tradicionalisht universiteti ynë ka përfaqësuar dhe promovuar vlerat më të larta të qytetërimit perëndimor të cilat janë pjesë e natyrshmërisë historike të kombit tonë

PËR NJË VIT,  
MË SHUMË SE  
8 000 FOSHINJA  
TË LINDURA



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Donald Trumpi dhe vendi pas gjyqit në Senat. Çfarë pritet të ndodhë?

WASHINGTON, 15 SHKURT - Në Uashington ligjvënësit po përballen me pasojat që solli gjyqi në Senat ndaj ish-presidentit Donald Trump. Ky u fundit u shpall i pafajshëm mbi akuzën për nxitje të rebelimit në Kapitol më 6 janar, shkruan "Zëri i Amerikës". Shumë pikëpyetje janë ngritur rreth asaj se çfarë pritet të ndodhë pas përfundimit të gjyqit në Senat ndaj ish-presidentit Donald Trump, i cili u shpall i pafajshëm lidhur me akuzën për nxitje të sulmit të dhunshëm më 6 janar ndaj Kapitolit.

Disa ligjvënës, mes tyre republikanë, kanë sugjeruar se ai mund të përballlet me pasoja të tjera. "Presidenti Trump është ende përgjegjës për gjithçka që bëri ndërsa ishte në detyrë, përjashtuar rastin kur përfundon periudha brenda së cilës ligji mund të veprojë. Si një qytetar i zakonshëm, ai është ende përgjegjës për gjithçka bëri, ndërsa ishte në detyrë. Ai nuk ia ka hedhur ende", ka thënë Mitch

McConnell, udhëheqësi i pakicës në Senat.

Por cilat mund të jenë pasojat? Trumpi ka ende fuqi të jashtëzakonshme brenda Partisë Republikane.

Pas vendimit në Senat, Trump lëshoi një deklaratë ku sugjeronte se lëvizja e tij politike sapo ka filluar. Megjithatë, disa republikanë, mes tyre edhe senatori i Luizianës, Bill Cassidy, i cili votoi për ta shpallur fajtor ish-presidentin, thonë se është koha që partia të shkëputet nga Trumpi. "Mendoj se forca e tij do të venitet. Partia Republikane është më shumë se një person i vetëm. Partia Republikane ka të bëjë me idetë", ka deklaruar senatori republikan Bill Cassidy.

Disa ligjvënës kanë bërë thirrje për ngritjen e një komisioni hetimor mbi 6 janarin, të ngjashëm me të ashtuquajturin komisioni i 11 shtatorit që hetoi sulmin terrorist të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara. "Ka ende shumë prova që populli amerikan ka nevojë dhe meriton t'i dëgjojë



dhe një komision si ai i 11 shtatorit është një mënyrë për të garantuar Kapitolin në të ardhmen. Ai do të ndihmojë për të zbuluar të dhëna se deri në ç'masë presidenti Donald

Trump shkeli betimin e tij përpara Kushtetutës", thotë senatori demokrat, Chris Coons.

Ligjvënësit e Senatit nuk arritën të siguronin 67 vota e

nevojshme për të shpallur fajtor ish-presidentin. Votimi u krye një muaj pasi Dhoma e Përfaqësuesve e akuzoi zyrtarisht Donald Trumpin për nxitje rebelimi.

## G7 do të diskutojë për shpërndarjen e barabartë të vaksinave

LONDËR, 15 SHKURT - Më 19 shkurt udhëheqësit e G7-s do të takohen për të diskutuar për pandeminë e koronavirusit dhe rimëkëmbjen e ekonomisë botërore, njoftoi Shtëpia e Bardhë. Kjo do të jetë hera e parë që presidenti amerikan Joe Biden do të takohet me liderët e grupit të vendeve më të fuqishme të botës. Ai e mori detyrën e presidentit më 20 janar.

Presidenti Biden do të fokusohet në vërejtjet e tij në lidhje me prodhimin dhe shpërndarjen e vaksinave në



nivel global, tha Shtëpia e Bardhë.

Mikpritës i takimit do të jetë kryeministri britanik Boris Johnson, ka njoftuar zyra e tij, duke thënë se temë kryesore do të jetë shpërndarja e barabartë e vaksinave në botë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka thënë më herët se një politikë "unë e para" ndaj vaksinave, nga ana e vendeve të pasura, mund të lërë vendet e varfra në rrezik të mungesës së vaksinave. Sipas OBSh-së, kjo politikë mund ta mundësojë përhapjen e koronavirusit.

Kryeministri Johnson gjithashtu do të bëjë thirrje që vendet e G7-s të punojnë në një qasje globale ndaj pandemive. G7 përbëhet nga Britania e Madhe, Gjermania, Kanadaja, Franca, Italia, Japonia dhe Shtetet e Bashkuara. Liderët takohet çdo vit për të diskutuar problemet me të cilat ballafaqohet bota. Samiti i vitit të kaluar, i cili do të organizohet nga Shtetet e Bashkuara, u anulua për shkak të pandemisë.

Liderët do të diskutojnë edhe për ndryshimin e klimës.

## Turqia dënon me burgim një aktiviste të të drejtave të njeriut

ANKARA, 15 SHKURT - Një gjykatë turke e ka dënuar aktivisten e të drejtave të njeriut, Eren Keskin, me gjashtë vjet burgim nën akuzat e anëtarësimit në një organizatë terroriste. Keskin është një nga avokatet më të njohura të të drejtave të njeriut në Turqi. Ajo ka shkruar në rrjetin social "Twitter" se shumë herë ka qenë e akuzuar për pikëpamjet e saj politike, por asnjëherë nuk është dënuar për anëtarësim në një grup terrorist.

Milena Buyumi, nga Amnesty International, e quajti vendimin një "padrejtësi të tmerrshme". "Eren Keskin është një avokate e të drejtave të njeriut që flet kundër padrejtësisë. Ajo i ka kushtuar jetën e saj mbrojtjes së të drejtave të grave, të burgosurve dhe ka luftuar për drejtësi", ka shkruar Buyum në rrjetin social "Twitter". Keskin ka qenë kryeredaktore nderi e së përditshmes prokurde "Ozgur Gundem". Kjo

gazetë u ndalua pas grushtit të shtetit të dështuar ushtarak më 2016.

Gjykata ka dënuar gjithashtu tre të pandehur të tjerë të lidhur me këtë gazetë.

Kryeredaktori i gazetës, Bilir Zana Kaya, u dënua me dy vjet e një muaj burg për shkak të propagandës terroriste. Dy individë të tjerë u dënuan me gjashtë vjet e tre muaj burg, raporton DPA. Vendimi mund të apelohej.





# Pas rezultatit të dobët të LDK-së në zgjedhje, Mustafa ofron dorëheqje



Isa Mustafa, pas mbledhjes së Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) mbajtur të hënën, ka konfirmuar para mediave se ka ofruar dorëheqje nga pozita e kryetarit të LDK-së. Mustafa ka thënë se rezultati i zgjedhjeve ka qenë shumë i keq për LDK-në. “Unë sot e kam njoftuar kryesinë se do ta thërras Kuvendin e LDK-së për zgjedhjen e kryetarit të ri në një periudhë të shpejtë kohore. Me statut e kemi 60 ditë që ta bëjmë këtë, mirëpo unë do ta bëj më shpejt”, ka thënë Mustafa

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka paralajmëruar të hënën se do të tërhiqet nga posti i kryetarit pas rezultatit të partisë së tij në zgjedhjet parlamentare të 14

shkurtit. “Kishim mbledhjen e kryesisë që e thirra unë pas rezultateve të zgjedhjeve. Rezultati është shumë i keq për LDK-në. Nuk e kemi pritur fare as nga puna në terren e as nga puna që ka bërë kryeministri Avdullah Hoti. Qytetarët e thanë fjalën e tyre përmes votës dhe në shenjë të respektimit të kësaj vote, unë

sot e kam njoftuar kryesinë se do ta thërras Kuvendin e LDK-së për zgjedhjen e kryetarit të ri në një periudhë të shpejtë kohore. Me statut e kemi 60 ditë që ta bëjmë këtë, mirëpo unë do ta bëj më shpejt këtë”, ka thënë Mustafa. Ai ka shtuar se nuk ka asnjë vërejtje sa i përket organizimit të procesit zgjedhor më 14 shkurt.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), LDK-ja ka dalë partia e tretë në zgjedhjet parlamentare të së dielës. Ajo ka fituar rreth 13 për qind të votave dhe ndodhet shumë larg partisë së parë, Lëvizjes Vetëvendosje, e cila ka siguruar rreth 48 për qind. Në vendin e dytë ka dalë Partia Demokratike e Kosovës, me rreth 17 për qind.

Kandidat për kryeministër i LDK-së në këto zgjedhje ka qenë kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, i cili të dielën vonë tha se procesi zgjedhor është zhvilluar me standarde evropiane dhe se ai e merr përgjegjësinë e plotë për rezultatin e LDK-së. “Unë e marrë

përgjegjësinë e plotë për këtë rezultat zgjedhor të LDK-së. Në ditët në vijim do të diskutojë gjerësisht me organet e LDK-së për këtë përgjegjësi. Unë do të jem gjithmonë mirënjohës për mundësinë që më është dhënë nga LDK-ja për t’u shërbyer qytetarëve dhe do të mbetem mbrojtës i pakompromis i demokracisë dhe orientimit pro-perëndimor të Republikës së Kosovës”, ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se LDK-ja do të jetë opozitë konstruktive në mbrojtje të interesit të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, LDK-ja ka fituar rreth 24 për qind të votave.

## Familja Dehari dorëzon kallëzim penal ndaj kandidatit të LDK-së për deputet

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Avokati i familjes Dehari, Tomë Gashi, ka ngritur kallëzim penal ndaj ish-kryeprokurorit dhe kandidatit të LDK-së për deputet, Sylë Hoxha. Sipas njoftimit, kallëzimi penal ka të bëjë me mosveprimet e tij si person zyrtar “kryeprokuror dhe prokuror në rastin e hetimit të vrasjes së aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari”.

Përmes një njoftimi është thënë se Hoxha nuk ndërmoi asnjë veprim të domosdoshëm në kuadër të detyrës së tij zyrtare lidhur me rastin. “Ashtu siç premtuam pas referendumit për Vetëvendosje, ne sot po e publikojmë kallëzimin penal kundër ish-kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ish-prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe

ish-kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës nga LDK-ja, Sylë Hoxha. Kryeprokurori, edhe prokuror, Sylë Hoxha, nuk ndërmoi asnjë veprim të domosdoshëm në kuadër të detyrës së tij zyrtare për të siguruar prova që do t’i identifikonin vrasësit e Astrit Deharit, urdhërdhënësit për vrasje dhe ata që e fshehën vrasjen e Astritit për më tepër se katër vjet”, ka thënë Gashi.







REZULTATET PRELIMINARE NXJERRIN FITUESE TË ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT, LËVIZJEN VETËVENDOSJE

# Humbësit pranojnë rezultatin, urojnë Vetëvendosjen

Rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë nxjerrë Lëvizjen Vetëvendosje fituese të zgjedhjeve parlamentare me 48 për qind të votave. Subjektet politike që kanë humbur zgjedhjet e 14 shkurtit kanë pranuar rezultatin dhe kanë uruar fituesin për fitoren më të thellë në historinë politike të Kosovës. Në bazë të mbi 99.20 për qind të votave të numëruara nga KQZ-ja, partia e dytë është renditur PDK-ja me 17 për qind, pasuar nga LDK-ja me 13 për qind dhe AAK-ja me 7 për qind dhe Nisma me mbi 2 për qind, e cila nuk e kalon pragun zgjedhor

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 SHKURT - Në bazë të 99.20 për qind të votave të numëruara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje është fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit me 47.89 për qind apo mbi 374 mijë vota. Sipas rezultateve preliminare, të publikuara në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, partia e dytë, Partia Demokratike e Kosovës, ka 17.36 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.08 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.40 për qind. Nisma Social Demokrate nuk

ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor prej 5-përqindësh, duke marrë 2.59 për qind. Rezultatet preliminare nuk përfshijnë votat me kusht, votat me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta. Zgjedhjet e 14 shkurtit janë mbajtur sipas standardeve të kërkuara ndërkombëtare. Vëzhguesit e këtyre zgjedhjeve kanë bërë me dije se tashmë Kosova është bërë shembull në rajon se si duhet të organizohen zgjedhjet. Avokati i Popullit që ka vëzhguar për së afërmi zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit ka vlerësuar se procesi është zhvilluar në mënyrë të qetë dhe sigurt. "Nga ajo që

është raportuar nga terreni, Avokati i Popullit konsideron se në tërësinë e vet, procesi zgjedhor është zhvilluar në një atmosferë të sigurt, të qetë, të lirë dhe demokratik. Pjekuria e qytetarëve në njërin anë, angazhimi maksimal të cilin KQZ-ja e ka treguar në tërësinë e vet në përgatitjet dhe në organizimin e këtyre zgjedhjeve, kanë shënuar çast jashtëzakonisht të rëndësishëm për respektimin e vullnetit të lirë të qytetarëve dhe nivelin e demokracisë në vend", është thënë në deklaratën e Avokatit të Popullit, duke shtuar se të gjitha institucionet kanë kryer punën që iu ka takuar. "Prandaj, nga perspektiva e

respektimit dhe e ushtrimit të kësaj të drejte politike, Avokati i Popullit shpreh konsideratën dhe vlerësimin e tij maksimal. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson Policinë e Kosovës për mbështetjen profesionale që ka ofruar përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve nëpër të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke garantuar siguri dhe mbarëvajtjen e procesit elektorale", ka vlerësuar Avokati i Popullit.

Disa orë pas mbylljes së vendvotimeve, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ka deklaruar se qytetarët u bënë bashkë dhe u vërtetua se zgjedhjet ishin referendum. Në një konferencë për media, para simpatizantëve të LV-së që ishin mbledhur për të festuar, Kurti ka thënë se referendumi për drejtësi e kundër kapjes së shtetit u fitua. "Rruga përpara është e gjatë. Do të kemi pengesa e do të bëjmë ndonjë gabim, por qëllimin e kemi fisnik. Nuk do të hakmerremi ndaj askujt, por do të kërkojmë drejtësi. Secili

nga ne duhet ta marrë përgjegjësinë që na takon, që ta bëjmë vendin tonë të jetueshëm. Ne e kemi bërë koalicionin me presidenten Vjosa Osmani dhe ky rezultat na konfirmon, që nuk kemi nevojë e as interes për ata që duhet të reformohen në opozitë", ka thënë ai.

**PDK-ja dhe LDK-ja do të jenë opozitë**

Pas rezultateve preliminare, partitë që kanë humbur zgjedhjet kanë uruar fituesin e zgjedhjeve dhe kanë treguar se në këtë mandat do të jenë opozitë.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, njëherësh kandidat i kësaj partie për kryeministër, e ka uruar Lëvizjen Vetëvendosje për fitoren dhe ka bërë të ditur se partia e tij nuk do të jetë pjesë e qeverisë. "PDK-ja nuk do të jetë pjesë e qeverisë me Lëvizjen Vetëvendosje pasi që kemi dallime të mëdha në orientimet tona politike dhe nuk bëjmë kompromis me



vlerat mbi të cilat është ndërtuar dhe në të cilat qëndron PDK-ja. Kosova ka nevojë për stabilitet dhe ne zotohemi se do të jemi faktor i stabilitetit si parti në opozitë”, tha Hoxhaj në një konferencë për media.

Më pas edhe kandidati për kryeministër i Lidhjes Demokratike të Kosovës, njëherësh kryeministër në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë se Kosova ka përmbyllur një proces të rregullt zgjedhor, duke e pranuar rezultatin zgjedhor.

“Rezultatet preliminare janë krejt të tjera prej atyre që kemi pritur. Prandaj, unë e marrë përgjegjësinë e plotë për këtë rezultat zgjedhor të LDK-së. Në

ditët në vijim do të diskutojmë gjerësisht me organet e LDK-së për këtë. Në emër të LDK-së ne do të jemi mbrojtës të pakompromis të demokracisë dhe të orientimit properëndimor, duke qenë opozitë konstruktive në interes të shtetit të Kosovës”, ka deklaruar Hoti.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka pranuar rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Në një konferencë për media ai ka thënë se në këtë legjislaturë kjo parti nuk do të jetë pjesë parlamentit, por do të vazhdojë ta mbikëqyrë punën e qeverisë së re. “Nisma si parti do të vazhdojë ta mbikëqyrë punën e atyre që populli ua ka dhënë

besimin, duke uruar partinë fituese të zgjedhjeve. Tani është koha për punë dhe qeverisje stabile për vendin tonë”, ka deklaruar Limaj.

Ai ka falënderuar qytetarët për pjesëmarrje të lartë në zgjedhje. “Unë edhe në emër të kryesisë falënderoj qytetarët. Ka qenë fushatë e jashtëzakonshme dhe kemi arritur objektivë të madhe. Besoj se të gjithë ata që tentuan t’i zbehin ato vlera gjatë fushatës elektorale filluan të kthehen. Ne nuk do të ndalemi. Unë sot ndihem krenar që shumë djem e vajza të lirisë së Kosovës ndihen çlirimtarë. Do të vazhdojmë së bashku që zërin e fuqinë ta promovojmë së bashku”, ka deklaruar Limaj.

## Shqipëria përgëzon Kosovën për zgjedhje demokratike

Krërët e shtetit shqiptar kanë përgëzuar Kosovën për organizimin e zgjedhjeve të lira e demokratike. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se sa më shpejt duhet të krijohen institucionet e reja. “Urime të gjithë qytetarëve dhe klasës politike të Kosovës për shembullin e shkëlqyer të besimit të demokracia dhe vota e lirë, si dhe për standardet e suksesshme të arritura në zgjedhjet e djeshme parlamentare. E përshëndes pjesëmarrjen e lartë të qytetarëve në votime, të cilët sfiduan kushtet e vështira atmosferike dhe pandeminë Covid-19, për të marrë në dorë fatet dhe për të vendosur të ardhmen e tyre. Kosova hapi një faqe të re në rrugëtimin e saj evropian dhe konsolidimit të shtetit demokratik. Urojmë që institucionet e reja, që do të formohen përmes bashkëpunimit, ta

udhëheqin me sukses shtetin e Kosovës për t’i fituar sfidat e të ardhmes”, është thënë në urimin e Metës.

Kurse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka uruar të gjitha partitë politike në Kosovë për zgjedhje të lira dhe demokratike dhe fituesen e këtyre zgjedhjeve, Lëvizjen Vetëvendosje. Rama ka thënë se pret që ky vullnet i popullit të Kosovës të mishërohet në një kapitull të ri për Kosovën, me qeveri të qëndrueshme, dialog konstruktiv ndërpartiak, zhvillim ekonomik e social. “Përshëndetje të gjitha forcave politike në Kosovë, posaçërisht fitueses së qartë të zgjedhjeve, LV-së, me urimin që vullneti i popullit të Kosovës të mishërohet në një kapitull të ri për Kosovën, me qeveri të qëndrueshme, dialog konstruktiv ndërpartiak, zhvillim ekonomik dhe social”, ka thënë Rama.

## Ambasada e ShBA-së përgëzon qytetarët për zgjedhjet

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë ka përgëzuar qytetarët e Kosovës për zgjedhjet e 14 shkurtit. Përmes një reagimi në faqen zyrtare në “Twitter”, ambasada ka vlerësuar se në

këtë ditë qytetarët dëshmuar përkushtimin për demokraci dhe vizion të së ardhmes. “I përgëzoj qytetarët e Kosovës që dëshmuar përkushtimin për demokraci dhe vizion të së ardhmes. Amerika qëndron krah

Kosovës dhe mezi pret të punojë me qeverinë e re, sapo të formohet, në qëllimet e përbashkët për paqe, drejtësi dhe prosperitet”, është thënë në reagimin e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

# BE-ja: Të vazhdojë dialogu me Serbinë

PRISHTINË, 15 SHKURT - Bashkimi Evropian (BE) në reagimet e para pas zgjedhjeve në Kosovë ka bërë thirrje që autoritetet e reja që do të dalin nga këto zgjedhje ta vazhdojnë angazhimin konstruktiv në dialogun me Serbinë. “Rruga evropiane e Kosovës po ashtu shkon edhe përmes normalizimit gjithëpërfshirës të raporteve me Serbinë dhe BE pret nga autoritetet në Prishtinë që të angazhohen në mënyrë konstruktive me qëllim të vazhdimin të takimeve në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe ta shfrytëzojnë rastin që kanë përpara për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse”, thuhet në një komunikatë të përbashkët të lëshuar nga përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri Josep Borrell dhe komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi, Oliver Verhelyi.

Dy zyrtarë e lartë evropianë përsëriten edhe gatishmërinë e BE-së për ta vazhduar mbështetjen ndaj Kosovës. “Më 14 shkurt qytetarët e Kosovës hodhën votën e tyre në zgjedhjet e parakohshme



parlamentare. Varësisht nga certifikimi i rezultateve përfundimtare, ne presim krijimin e Kuvendit të ri, të qeverisë dhe presidentit të ri”, thuhet në këtë komunikatë.

Aty thuhet se “Bashkimi Evropian kishte dërguar një mision ekspertësh zgjedhorë i cili do të mbetet në Kosovë për t’i ndjekur edhe procedurat

pas zgjedhore si dhe për të dhënë rekomandime”. “Bashkimi Evropian do të vazhdojë të angazhohet me autoritetet, me qëllim të mbështetjes së Kosovës për arritjen e progresit të prekshëm në rrugën evropiane. Kjo kërkon që Kosova të avancojë në reforma, të drejtuara nga Marrëveshja e

Stabilizim Asocimiit dhe Agjenda Evropiane e Reformave, si dhe nga bashkëpunimi rajonal”, shprehen Borrelli dhe Verhelyi në komunikatën e përbashkët të lëshuar për zgjedhjet në Kosovë.

Nën ndërmjetësimin e BE-së, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Pas

një pauze 20-mujore, dialogu rinisi në korrikun e vitit 2020.

Takimi i fundit i udhëheqësve të Kosovës dhe Serbisë u zhvillua në shtatorin e vitit të kaluar. Deri në zgjedhjen e qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut.



# Një i vdekur dhe 178 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 040 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 178 raste pozitive me Covid.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid.

Rasti i vdekjes është nga komuna Prishtinë (65 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 64 519 raste nga 268 625

persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 545 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 267 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 56 028 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 946.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 57 raste, Mitrovicë 15 raste, Pejë 15 raste, Gjakovë 12 raste, Podujevë 12 raste, Ferizaj 8 raste, Fushë-Kosovë 8 raste, Gjilan 5 raste, Lipjan 5 raste, Obiliq 5 raste, Prizren 5 raste, Rahovec 5 raste, Deçan 4 raste, Skenderaj 4 raste, Vushtrri 4 raste, Malishevë 3 raste, Drenas 2 raste, Suharekë 2 raste dhe nga një rast komunat Dragash, Istog, Junik, Kaçanik, Klinë, Shtërpçë dhe Viti.



## Për një vit, më shumë se 8 000 foshnja të lindura



PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Gjatë vitit 2020 në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë lindur 8 786 foshnja, prej

tyre 3 128 me operacion. Vitin e shkuar janë ofruar edhe shërbime të tjera shëndetësore, por në pjesën më të madhe të tij mjekët kanë trajtuar kryesisht

rastet me urgjencë për shkak të situatës me Pandeminë Covid-19.

Në raportin vjetor të punës figurojnë 1 769 operacione të

kryera të natyrës urgjente si: karcinoma, cist dhe shtatzëni jashtë mitrës.

Me anestezion të shkurtër intravenoz janë realizuar 2 477

intervenime.


Me udhëzim të mjekut, në Klinikën e Gjinekologjisë, në 12 muajt e vitit të kaluar janë regjistruar 14 370 pranime.

## Ministria e Shëndetësisë pranon donacion për blerjen e testeve PCR

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe shefi i Zyrës Ndërlidhëse i Republikës Sllovaqe në Prishtinë, Rastislav Kostilnik, kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit nëpërmjet të

cilit, Ministria e Shëndetësisë pranon donacion për blerjen e testeve PCR. "Ky kontribut financiar do të përdoret për sigurimin e testeve Covid-19, duke iu shtuar donacioneve shumë të çmuara nga vendet mike në kohë pandemie. E

sigurova z. Kostilnik, se rruga jonë, synimi ynë madhor, është rruga integruese euroatlantike, duke ndarë vlerat dhe synimet e përbashkëta me qytetarët dhe institucionet e vendit mik - Sllovakisë", ka thënë ministri Zemaj.





Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” feston 51-vjetorin e themelimit

# Sahiti: UP-ja vazhdon të ketë rol prijës në lëvizjet shoqërore për demokratizim



Rektori i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka thënë se UP-ja vazhdon të ketë rol prijës në lëvizjet shoqërore për demokratizim, zhvillim dhe qëndrueshmëri. Në 51-vjetorin e themelimit të UP-së, rektori Sahiti ka theksuar se tradicionalisht universiteti ynë ka përfaqësuar dhe promovuar vlerat më të larta të qytetërimit perëndimor të cilat janë pjesë e natyrshmërisë historike të kombit tonë

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 SHKURT - Me ceremoni solemne të hënë Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka shënuar 51-vjetorin e themelimit të tij. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin menaxhmenti i UP-së, anëtarët e Këshillit Drejtues, si dhe dekanët e njësive akademike. Ceremonia u hap me performancën virtuale të Paganini Etide Nr. 6, nga studentja Melisa Ibrahim, së fundi fituese e çmimit të parë në garën ndërkombëtare “International Music Competition Moscow”. Të pranishmëve iu drejtua me fjalë rasti rektori prof. dr.

Naser Sahiti, i cili uroi përvjetorin e 51-të të UP-së, i cili, siç tha ai, po ndodh në rrethana jo të zakonshme. “Sot, në rrethana jo të zakonshme, po e shënojmë 51-vjetorin e themelimit të universitetit tonë. Tradicionalisht, kjo ditë bashkon në kompleksin e UP-së studentët, stafin dhe partnerët tanë, por në rrethanat e krijuara nga pandemia Covid-19, këtë vit po e shënojmë këtë ditë në një formë tërësisht jo të zakonshme”, ka deklaruar rektori. Ai ka shtuar që kufizimet e pandemisë e kanë penguar, por nuk e kanë ndaluar UP-në që të punojë në përgatitjen profesionale të studentëve.

“Tradicionalisht, universiteti ynë ka përfaqësuar dhe promovuar vlerat më të larta të qytetërimit perëndimor, të cilat janë pjesë e natyrshmërisë historike të kombit tonë. Në këtë kontekst, UP-ja vazhdon të ketë rol prijës në lëvizjet shoqërore për demokratizim, zhvillim dhe qëndrueshmëri”, theksoi rektori. Rektori Sahiti, për nder të Ditës së Universitetit, si dhe për ta vlerësuar suksesin e studentëve, ka organizuar ceremoni pritëse për studentët e dalluar të të gjitha njësive akademike të UP-së, të cilët i ka shpërblyer me mirënjohje. Universiteti i Prishtinës është themeluar me Ligjin mbi Themelimin e Universitetit të

## Në përvjetorin e UP-së, rektori Sahiti u jep mirënjohje studentëve të dalluar

Në përvjetorin e 51-të të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, studentët e dalluar të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës u shpërblyen me mirënjohje për rezultate të shkëlqyera gjatë studimeve. Ata u pritën në takim nga rektori prof. dr. Naser Sahiti, i cili i përgëzoi për suksesin e treguar gjatë studimeve. Studentët e

pranishëm u shprehën të lumtur me këtë vlerësim nga rektori Sahiti. Të njëjtët theksuan se pranimi i këtij titulli në Ditën e Universitetit është nder, por edhe përgjegjësi për të shënuar edhe më shumë suksese në të ardhmen. I pranishëm në ndarjen e mirënjohjeve ishte edhe kryetari i Parlamentit Studentor, Erzen Hyseni.

Prishtinës, të cilin e miratoi Kuvendi i Krahinës Socialiste të Kosovës më 18 nëntor 1969. Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte ngjarje historike për popullin e Kosovës si dhe për mbarë kombin shqiptar. Kuvendi

themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më vonë, më 15 shkurt 1970, u mbajt edhe mbledhja solemne e Kuvendit dhe pikërisht kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës.

## Ambasadorja e Suedisë konfirmon mbështetjen për Agjencinë Kundër Korrupsionit

PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Në kuadër të takimeve me përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë, drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka pritur në takim ambasadorën e Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, ku ka diskutuar për rolin dhe fushëveprimin e AKK-së për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. Havolli e ka njoftuar ambasadorën suedeze për

punën e AKK-së në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, procesin e deklarimit të pasurisë si aktivitetet në parandalimin dhe luftimin e konfliktit të interesit. Gjithashtu, në takim është diskutuar edhe për iniciativat e realizuara për ndryshimet dhe avancimet në kornizën ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë. Gjatë këtij takimi ambasadorja Hernmarck Ahliny ka vlerësuar punën dhe progresin e arritur nga AKK-ja dhe ka konfirmuar



mbështetjen e vazhdueshme edhe në të ardhmen të Ambasadës dhe të shtetit të Suedisë për Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Drejtori i AKK-së, Havolli, ka falënderuar Ambasadorën Hernmarck Ahliny për përkrahjen e Qeverisë së Suedisë përmes mbështetjes së Projektit “Përkrahja e përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK III)”, të implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



# Përfaqësuesit e bizneseve bëjnë thirrje për krijimin sa më shpejt të qeverisë së re



Përfaqësuesit e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare kanë bërë thirrje për krijimin e qeverisë së re. Sipas tyre, çdo prolongim i krijimit të institucioneve të reja do të shkaktojë dëme të thella ekonomike dhe dëmtim të sektorit privat. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se Kosova ka nevojë për një qeverisje të qëndrueshme e cila do të mund të shtynte përpara një agjendë dinamike të reformave ligjore në të gjitha sferat, me theks të veçantë në qeverisjen ekonomike

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 SHKURT - Përfaqësuesit e odave të afarizmit vendor dhe ndërkombëtar u kanë bërë thirrje politikëbërësve në Kosovë që sa më shpejt ta formojnë qeverinë e re në mënyrë që të merret me çështjet ekonomike. Sipas tyre, është nevojë urgjente që qeveria e re të merret me rikuperimin e dëmeve të shkaktuara nga Covid-19, të fuqizohet sektori privat, sektori i energjisë, të punohet për krijimin e vendeve të reja të punës dhe të punohet më shumë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Lidhur me këtë, drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane (OEAK), Arian Zeka, ka përmendur ligjet të cilat duhet të jenë prioritet në qeverisjen e ardhshme. Zeka ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova ka nevojë për qeveri stabile në mënyrë që të ketë përparim ekonomik në vend. "Kosova ka nevojë për një qeverisje të qëndrueshme e cila do të mund të shtynte përpara një agjendë dinamike të

reformave ligjore në të gjitha sferat, por me theks të veçantë në qeverisjen ekonomike. Qeveria e re duhet të ketë parasysh që efektet e reformave që ata synojnë, duhet të shtrihen përtej kohëzgjatjes së një mandati qeverisës. Qeveria e re duhet të përpiqet ta përmbushë agjendën legjislative, e cila përfshin një sërë ligjesh nga fusha ekonomike, siç janë projektligjet tatimore, Projektligji për Gjykatën Komerciale, Projektligji për investimet strategjike etj", u shpreh ai.

Pos këtyre projektligjeve, sipas Zekës, me prioritet të veçantë duhet të shikohen edhe dëmet e shkaktuara nga Covid-19. "Sidoqoftë, me prioritet të lartë duhen adresuar edhe dëmet e shkaktuara nga pandemia Covid-19 dhe të ridizajnohet struktura ekonomike e vendit, për të cilën do të duhej të fuqizonte dialogun me sektorin privat, por edhe hisedarët e tjerë jopolitikë", u shpreh ai.

Zeka ka deklaruar se vonesat për formimin e institucioneve të reja përkthehen në regres të reformave ekonomike. "Vonesat në konstituimin e Kuvendit dhe

krijimin e qeverisë së re do të nënkuptonin edhe vonesë në procesin e reformave dhe përparimit ekonomik dhe social, prandaj politikëbërësit duhet t'i shmangin vonesat e panevojshme", u shpreh ai.

Edhe kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës (OEAK), Berat Rukiqi, ka thënë se është mirë që sa më shpejt qeveria e re të merret me trajtimin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia.

Rukiqi ka numëruar çështjet të cilat duhet të jenë prioritet ekonomik i ligjvënësve. "Qeveria e re duhet ta trajtojë menjëherë çështjen e rikuperimit të dëmeve të shkaktuara nga pandemia dhe pasojat e shkaktuara në vitin që lëmë pas, por edhe sfidat e këtij viti", ka thënë Rukiqi për gazetën "Epoka e re".

Pos rikuperimit të dëmeve, Rukiqi ka thënë se hapat e parë të qeverisjes së re duhet të jenë: fokusimi në forcimin e sektorit privat, sektori i energjisë dhe angazhimi në drejtim të shkathtësive të tregut të punës. "Pasojat e shkaktuara nga pandemia janë ende evidente, prandaj ky duhet të jetë fokusi kryesor pa anashkaluar asnjëherë forcimin e sektorit

privat, aftësimin në shkathtësitë që i kërkon tregu, krijimin e vendeve të punës si dhe fokusimin në sektorin e energjisë", u shpreh Rukiqi.

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se vonesat e krijimit të qeverisë në aspektin ekonomik mund të jenë shumë dimensionale. "Vonesat për krijimin e qeverisë së re, nëse do të ndodhë një gjë e tillë, do të jenë shumë dimensionale. E para, një vonesë e tillë do të kishte pasojat të mëdha dhe të parikuperueshme në shëndetin publik, në qoftë se me kohë nuk do të sigurohen vaksinat anti Covid-19. E dyta do të shkaktonte vonesat në fillimin e zbatimit të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike dhe, e treta, në qoftë se do të kishte vonesat të tilla, ato do ta zbehnin një proces shumë të rregullt dhe demokratik zgjedhor. Ne presim që këto vonesat mos të shfaqen pasi që kemi një forcë politike e cila ka arritur një fitore bindëse dhe që na jep të besojmë se edhe formimi i institucioneve të reja do të arrijë ta menaxhojë në mënyrë më të mirë të mundshme", u shpreh ai.


Ujkani e ka konsideruar me urgjencë zbatimin e planit për rimëkëmbje ekonomike. "Qeveria e re duhet të fokusohet në zbatimin e planit për rimëkëmbje ekonomike. Kjo është e domosdoshme. Prandaj, apeloj që qeveria e re të fokusohet në fuqizimin e sundimit të ligjit, i cili gjithsesi mendojmë se do të jetë një parakusht për zhvillimin

ekonomik, ku do të ndihmonte në tërheqjen e investimeve të huaja direkte", ka deklaruar Ujkani. Sipas tij, reforma e infrastrukturës ligjore dhe rekomandimet e dala nga White Book 2020 duhet të jenë prioritet i qeverisjes së re. "Për këtë arsye ne si EIC vlerësojmë shumë të nevojshme një reformë gjithëpërfshirëse të infrastrukturës ligjore e cila ndërlihet me tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Kosova ka potencial për të qenë një vend atraktiv për investitorët e huaj. Ne si KIE ftojmë qeverinë e re që krahas përgjegjësisë të tjera, ta marrë shumë seriozisht zbatimin e rekomandimeve që dalin nga dokumenti White Book 2020", u shpreh ai.

Edhe drejtori i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skender Krasniqi, ka thënë se si pasojë e stabilitetit politik në vend, sektori privat është përballur dhe vazhdon të përballet me shumë sfida. Ai ka bërë thirrje për krijimin sa më parë të institucioneve të reja. "Ne si Odë e Afarizmit të Kosovës jemi duke monitoruar punën të cilën është duke e kaluar sektori privat. Si pasojë e mungesës së qeverisjes stabile dhe stagnimit të shumë ligjeve dhe projektligjeve që kanë të bëjnë me ekonominë, sektori privat vazhdon të sfidohet. Bizneset në Kosovë po përballen me humbje të mëdha. Kjo po ndodh edhe si pasojë e pandemisë, por edhe jostabilitetit politik", u shpreh Krasniqi, duke shtuar se bizneset janë duke u përballur me vështirësi financiare, pa mundur t'i mbulojnë as shpenzimet.



## Mbahet takimi fillestar i menaxhmentit të lartë të ATK-së me FMN-në



PRISHTINË, 15 SHKURT (ER) - Përmes platformës virtuale menaxhmenti i lartë i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) ka mbajtur takimin fillestar me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për këtë vit. Pikat e diskutimit në këtë

takim ishin mbi proceset e ndryshme të ATK-së, duke përfshirë këtu gjendjen me Covid-19 në Kosovë si dhe ndikimin e saj në ATK dhe përpjekjet për zbutjen e këtij ndikimi. Po ashtu, pjesëmarrësit e këtij takimi folën dhe prezantuan

përpjekjet për reforma deri më tani, sfidat me të cilat proceset e përmendura janë ballafaquar gjatë implementimit, si dhe çështje të tjera që janë të rëndësishme për misionin e FMN-së. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Ekrem

Hysenaj, duke përmendur gjitha zhvillimet të cilat e kanë përcjellë institucionin e ATK-së, ka thënë se mbështetja e misionit të FMN-së do të jetë e mirëpritur si çdoherë, veçanërisht në këtë periudhë kur rrethanat e pandemisë kanë ndërruar në masë të

madhe planifikimet dhe pritjet e ATK-së. Veç të tjerash, përmes këtij takimi virtual u diskutuan edhe pikat tek të cilat ATK-ja ka nevojë për mbështetje të misionit të FMN-së. Ky mision do të jetë prezent virtualisht në ATK deri më 10 mars.

## MF-ja njofton për subvencionimin e linjës së pagave në kuadër të pakos së rimëkëmbjes



Prishtinë, 15 shkurt (ER) - Komisioni i Ankesave në kuadër të Ministrisë së Financave ka njoftuar tatimpaguesit se vendimi nr. 03/59 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ndarje buxhetore prej gjashtë milionë e pesëqind mijë eurosh

(6,500,000.00 euro), si vazhdimësi e vendimit nr. 10/33 me ndarje buxhetore prej gjashtëdhjetë milionë euro (60,000,000.00 euro) është ekzekutuar. "Tatimpaguesit të cilët vlerësojnë se i plotësojnë kriteret dhe nuk kanë përfituar subvencionim, mund të

parashtrorjnë ankesë në postën elektronike ankesa.mf@rks-gov.net, duke filluar nga sot deri më 16.03.2021. Ankesa duhet ta përmbajë numrin unik identifikues të tatimpaguesit apo në rast se tatimpaguesi nuk posedon numrin unik

identifikues, duhet të përmbajë numrin fiskal. Në kuptim të njoftimit të Komisionit të Ankesave të datës 26.01.2021, vetëm ankesat e dorëzuara nga sot e tutje do të merren në shqyrtim. Po ashtu, vetëm ankesat lidhur me

subvencionimin e linjës së pagave në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, të parashtruar nga data 01.02.2021 e tutje do të shqyrtohen, në përputhje me mandatin e Komisionit të Ankesave", ka njoftuar MF-ja.



## Ekipe të terren, Lladrovci përcjell nga afër gjendjen e rrugëve

DRENAS, 15 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka njoftuar qytetarët se kompania për pastrimin e rrugëve po punon gjatë gjithë kohës për mirëmbajtjen e tyre. Në ndihmë vullnetarisht ka dalë kompania "Arbo Tec", me pronar Hektor Beqiri, e cila ka angazhuar tri ekipe për pastrimin e rrugëve. "Pavarësisht që gjatë gjithë natës kompania u angazhua për pastrimin e rrugëve dhe sot që nga orët e hershme gjendja në disa fshatra akoma është e vështirë. Kompania e kontraktuar për pastrimin e rrugëve ka dyfishuar kapacitetet e saj

dhe po punon maksimalisht që ju qytetarë t'i kryeni shërbimet e juaja dhe, natyrisht, edhe të keni mundësi të ushtroni të drejtën kushtetuese - votimin. Në ndihmë të kompanisë ka dalë vullnetarisht miku im Hektor Beqiri me kompaninë e tij 'Arbo Tec' me tri ekipe dhe që bashkë janë në terren të angazhuar për pastrimin e rrugëve të qytetit dhe të gjitha fshatrat e komunës", ka thënë Lladrovci. Ai ka bërë me dije se ekipet nuk do ta ndalin punën derisa të gjitha rrugët të jenë të kalueshme dhe trafiku të zhvillohet pa pengesë.



## Numri i rasteve aktive me Covid në Gjilan është 105



GJILAN, 15 SHKURT (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin e të hënës për vlerësimin e situatës së pandemisë në dy ditët e fundit. Në emër të Komitetit, Ismajli u ka bërë

thirrje qytetarëve dhe bizneseve që japin shërbime, që t'u përmbahen masave kundër përhapjes së virusit, siç janë maska, distanca dhe higjiena personale. Ai bëri me dije se numri i rasteve aktive në Gjilan aktualisht është 105. Ndryshe gjendja e

përgjithshme në Gjilan është si vijon: nga 10 543 mostra, 3 555 kanë rezultuar pozitivë, 3 340 janë shëruar, 110 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 105 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 16 persona dhe 190 mostra në pritje për rezultat.

## Platforma 'E-shpenzimet', tani në uebfaqen e Komunës së Podujevës

PODUJEVË, 15 SHKURT (ER)- Në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Komuna e Podujevës ka krijuar platformën digjitale "E-shpenzimet", përmes së cilës tani e tutje çdo shpenzim i komunës do të pasqyrohet në uebin e komunës. Komuna ka aktivizuar programin e publikimit të të gjitha shpenzimeve komunale në mënyrë që qytetarët të kenë një pasqyrë të qartë lidhur me paratë e shpenzuara.

Platforma "E-shpenzimet" paraqet transparencë që është një tregues esencial për mënyrën e qeverisjes së mirë të institucionit nga zyrtarët e saj. Kjo platformë, pos që u mundëson qytetarëve të kenë qasje në informata, që kanë të bëjnë me shpenzimet e zyrtarëve, është mjet që shërben luftimin e keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të fondeve publike.



**E-SHPENZIMET**

## Kryetari Jashari apelon drejtuesit e automjeteve që ta shtojnë kujdesin në komunikacion

SKENDERAJ, 15 SHKURT (ER) - Udhëheqësi i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se që nga fillimi i reshjeve të borës ka angazhuar Drejtorinë e Shërbimeve Komunale dhe kompanitë e kontraktuara që ta bëjnë pastrimin dhe

zhbllokimin e rrugëve lokale në qytet dhe fshatra të komunës sonë. Kryetari Jashari, po ashtu, ka thënë se reshjet e pandërprera gjatë natës së mbrëmshme kanë vështirësuar punën për pastrimin e rrugëve, mirëpo puna nuk është ndalur


asnjëherë dhe po vazhdon ende në të gjitha fshatrat. Jashari ka porositur të gjithë drejtuesit e automjeteve që të shtojnë kujdesin gjatë këtyre ditëve në komunikacion. "Ne nuk ndalemi, vazhdojmë punën në shërbim të qytetarëve", tha Jashari.





# Zgjedhjet në Kosovë dhe rezultati

Koha e Vetëvendosjes erdhi në çastin e duhur.  
Sfida e vërtetë për Albin Kurtin dhe ekipin e tij nis tani



Nga Bedri ISLAMI

Më 14 shkurt në Kosovë u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, të cilat, si një shenjë e lëkundshmërisë së pushtetit, për të dytën herë zhvillohen me një qeveri në detyrë e, për më tepër, kësaj radhe, me ushtruese të detyrës së presidentit, që në të njëjtën kohë është edhe numri dy në listën e një force politike, me të cilën 15 muaj më parë ishin në garën e marrjes së pushtetit.

Janë zgjedhjet më të veçanta në Kosovë. Nga të gjithë dihet se kush do të jetë fituesi i tyre nuk dihet vetëm se sa lart do të shkojë, por rritja mund të jetë më shumë se 50 për qind dhe do të mund të kemi për herë të parë në qeverisje një forcë të vetme politike, e cila nuk do të kishte nevojë për mbështetjen e Listës serbe. Lëvizja Vetëvendosje ndryshe nga tetori i vitit 2019, kur ishte forcë e parë, tani do të jetë forcë politike fituese. Mijëra qytetarë të Kosovës, nga vende evropiane, janë kthyer dhe kane votuar pikërisht Lëvizjen Vetëvendosje.

Nga ana tjetër, megjithëse të ndarë nga njëra-tjetra, janë katër forca të tjera politike, të cilat, me gjithë zërin e ngritur, e dinë fare mirë se do ndajnë me njëra-tjetrën vendet pasuese, por nuk do të kenë as gjysmën e votuesve që kanë pasur tradicionalisht. Rreth 27 parti politike e koalicionet të vogla u përballën sot. Prej tyre janë pesë parti politike shqiptare, që përfaqësojnë rreth 95 për qind të votuesve dhe 22 të tjera të nacionaliteteve e pakicave etnike, që, megjithëse bartin vetëm 5 për qind të popullsisë, kanë të sigurta 20 vende në parlamentin prej 120 deputetësh. Prej tyre, sipas Kushtetutës, 10 vende janë të rezervuara për pakicën serbe, që kokën e ka në Beograd e han në të dy grazhdet: të Prishtinës dhe të shtetit serb.

Nga pesë partitë politike shqiptare, katër prej tyre kanë të njëjtën fillësë: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe figura të njohura nga Lëvizja Popullore e Kosovës. Kjo nuk përbën asnjë risi, kështu ka qenë edhe në zgjedhjet e kaluara, e, si duket, kështu do të vazhdojë edhe për shumë kohë, megjithëse në të gjitha janë pjesë

edhe shumë figura të shquara intelektuale të një brezi të ri, shumë i formuar dhe pasionant për të qenë pjesë e politikës.

Lëvizja Vetëvendosje është shndërruar momentalisht në forcën politike që i jep kahun fushatës. Duke hequr nga vetja ndalesa të mëhershme, si ajo në qëndrimin e saj ndaj figurës së Rugovës, ndoshta edhe për shkak se në Listën e saj zgjedhore gjendet edhe 12 kandidatë të Vjosa Osmanit; një stepje, ndoshta të përkohshme ndaj idesë së bashkimit kombëtar; relaksimim në marrëdhëniet me figura të njohura të mendimit politik ndërkombëtar; në fakt ajo e di se zgjedhjet janë të fituara dhe ka përgatitur prej kohësh edhe ekipin e ri drejtues qeveritar.

ndryshe dhe shpresa për ndryshim, gjithnjë e më shumë, po i ngjan një trendi të ripërsëritur.

Katër forca politike shqiptare janë në të njëjtën kohë rivalët e Kurtit dhe të katër liderët e dinë fare mirë se, me gjithë shpresën që i japin vetes, do të jenë nën kuotat e 15 muajve më parë. Partinë Demokratike të Kosovës e ka goditur fort mungesa e Thaçit, që disa vite më parë ishte lideri më i votuar dhe njeriu që ngjallte shpresën për ndryshim ndaj nomenklaturës së LDK-së, që vinte nga klani i vjetër i shtetit serb.

Thaçi në Hagë, si ishte 15 muaj më parë i përjashtuar nga fushata për shkak të detyrës, mes të tjerave e dëmtoi PDK-në pasi asnjëri prej

mes besimit dhe mosbesimit. E kam njohur prej shumë viteve Haradinajn dhe, sado që ka mendime të ndryshme për të, njohja ime më ka shtyrë dhe më qëndron në mendimin se pak njerëz e duan Kosovën si e do ai dhe se, paraqitja e tij publike është në raport të zhdrejtë e qasjen e tij politike.

Zotërues i shumë gjuhë të huaja ai e nuhat politikën në Kosovë të lidhur me pushtetin, ndërsa jashtë saj bën zgjedhje jo të duhura. Kjo ndodhte e ka bërë atë dhe forcën e tij politike të jetë më shumë rajonale dhe jo gjithëpërfshirëse, por edhe njohës të mirë të detantës në politikën shqiptare të Kosovës.

Shumë vetë ia kanë harruar faktin e krijimit të qeverisë së parë të

Hagë ka larguar një figurë politike të njohur, që kishte ndikim në shumë zona për shkak të së kaluarës së tij dhe qëndrimeve të matura, por askush nuk e di tani se sa i rëndë do të jetë dëmi.

Kisha menduar se Nisma dhe PDK, për shkak të së kaluarës së përbashkët, do të ishin në një listë të vetme zgjedhore, por, si duket, ndarja kishte qenë më e rëndë se sa duhej dhe këtë e vunë re, ose e thelluan, të rinjtë që ishin bërë pjesë e PDK-së dhe që mendojnë se tani është koha e tyre.

Koha e Vetëvendosjes erdhi në çastin e duhur. Prova e parë, e bërë një vit më parë, tregoi se kishte qenë e parakohshme, e pamjaftueshme dhe jo e duhur. Kishte dështuar, së pari në mendimin e Kurtit e pastaj në përplasjen e tij, jo të rastësishme me Agim Veliun e LDK-së, si përfaqësuesin e skifterëve brenda forcës rugoviste, që pak ka mbetur prej saj.

Të qeverisësh pas një besimi thelbësor është ndoshta përgjegjësia më e madhe për një forcë politike dhe, për një lider që i ka joshur njerëzit me ndryshime të mëdha dhe perspektiva të shkëlqyera, të cilat do e ketë të vështirë t'i bëjë, edhe sikur të vendosë gjithçka në lojë, në kohën që duan njerëzit.

Në Kosovë, nga luajlizmi ndaj liderëve, shumë vetë do të mbrojnë çështje që nuk u duket e drejtë. Toleranca politike ka marrë dëmtime serioze dhe do të jetë vështirë për një drejtues, që, duke qeverisur, të mbajë edhe peshën e tolerancës mes njerëzve, pa ngjallur mërinë e askujt, as të fituesve, që shpesh herë duan revansh të lodhur nga pritja e gjatë, dhe as të të mundurve që, para se të rrezohen, mendojnë revanshin. Pak vetë, nga ata që do të jenë të humburit e zgjedhjeve të këtij 14 shkurti, do të mendojnë ashtu si e kishin sanksionuar anglezët në parlamentin e tyre në vitin 1643, se "pakica duhet t'i nënshtrohet shumicës, t'i japë kësaj mundësi për të qeverisur dhe ta bëjë oponentin e saj". Interesat e njerëzve mund të bien në ujdi, por jo ndërgjegjet. Në Kosovë pritet të qeveriset me ndërgjegje dhe vizion, e jo të bien në ujdi, si ka ndodhur shpesh herë.

Ujdia e përkohshme do të jetë e dëmshme, sepse ngjall përplasjet e nesërme. Këtë e provoi Lëvizja Vetëvendosje një vit më parë, në ujdinë e saj me LDK-në, por ndodhitë e mëpasshme treguan se kishte qenë fillësë e përplasjeve.



Duke mos i lënë asgjë në dorë rastësisë, sidomos aty ku mund të hasen pengesa për emërimin e Kurtit si kryeministër, ajo e ka shndërruar gjithçka të saj në një lidhje të furishme mes forcës politike dhe liderit të saj, që tashmë janë simbiozë e qëndrueshme.

Më shumë se një lëvizje për të marrë pushtetin, ajo konceptohet tani si një lëvizje për ndryshimin e domosdoshëm, largimin nga skena politike drejtuese të forcave të tjera politike - çka është tashmë lajtmotiv i lëvizjes qytetare drejt LV-së, dhe, për më tepër, për të sjellë një frymë e vizion të ri qeverisës, ku lufta kundër korrupsionit të jetë lirimi i shtetit nga ngërçi.

Se sa do të arrihet e gjithë kjo, si dhe në cilën kohë dhe çfarë reaksioni mund të ngjallë, kjo është temë e së ardhmes. Aktualisht askush në Kosovë, nga përkrahësit e zjarrtë të Kurtit, nuk mendon se mund të ndodhë

tyre dhe të gjithë së bashku nuk kishin e nuk kanë karizmën e tij, e cila, me gjithë mëkatet e keq-qeverisjes, ka mbetur e pranishme dhe është rritur pikërisht për shkak të burgosjes së tij.

Duke shtuar këtu edhe mungesën e Veselit, i cili ishte më i hapur për njerëzit dhe më i qartë se drejtuesit e tanishëm, duket se synimi i saj do të mbetet të jetë forcë e dytë politike, ndërsa shpresa e vetme për të qenë në pushtet është që Kurti dhe LV-ja të mos arrijnë të kenë aq shumë deputetë sa që të mund të formojnë të vetëm qeverinë. Drejtuesi i tanishëm i saj, Enver Hoxhaj, në fakt intelektual i klasit të parë, me gjithë besimin e dhënë nga forca e tij politike, ende ka në figurën e tij reminishenca të së shkuarës, që, të vërteta ose jo, ato i janë bërë pjesë e fushatës.

AAK-ja dhe Haradinaj mbetën gjithnjë në forcat dhe liderët politikë që gjenden gjithmonë

përbashkët mes tij dhe Rugovës, por, pikërisht kjo zgjedhje e tij, krijimi i një qeverie të përbashkët mes pacifistëve rugovianë dhe luftëtarëve të orëve të para bëri që shërbimi i posaçëm serb dhe prokuroria hetuese serbe të shpejtonin në përgatitjen e dosjes së manipuluar dhe dërgimin e tij në Hagë, duke ia prerë rrugën një qeverie që mund të ishte deri më tani, më e suksesshme se të tjerat. Limaj dhe struktura e tij politike Nisma ka para vetes enigmën e së ardhmes; do të jenë apo jo në parlamentin e ardhshëm. Megjithëse aty ka figura të shquara dhe intelektualë të klasit të parë, përsëri hapësira politike që mendonte të zinte tashmë është e bosht dhe tjetër nuk mund të gjendet.

Të revoltuarit me PDK-në apo të zhgënjyerit e LDK-së, që mendoheshin të ishin pjesë e Nisma, tani, jo rastësisht, shkuan te Lëvizja Vetëvendosje! Largimi i Krasniqit dhe burgosja e tij në



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Dy ndeshjet e Superligës përfundojnë baras

Feronikeli - Gjilani dhe Trepça '89 - Arbëria kanë luajtur baras në ndeshjet e para për sezonin pranveror në elitën e futbollit të Kosovës, ndërsa në kuadër të kësaj xhiro fitore kanë shënuar Drita, Ballkani dhe Prishtina ndaj Llapit, Besës dhe Drenicës



në pozitën e katërt në tabelë me 30 pikë, derisa Feronikeli është një pozitë më poshtë me 24 pikë. Trajneri i Gjilanit, Bylbyl Sokoli, pas ndeshjes ka deklaruar: "Nuk jam i kënaqur as me lojën as me rezultatin. Kemi bërë shumë gabime në të gjitha fazat. Kjo është e patolerueshme. Në këtë formë i jemi qasur lojës e kështu nuk shkon. Kemi dalë jashtë krejt përgatitjeve që janë bërë për këtë ndeshje. Nuk ishim marrë vesh kështu. Duhet të synojmë të tregojmë lojëra cilësore. Ky ekip

mund të bëjë shumë më tepër. Nuk guxon të luajë në formë të luhatshme. Ne sot kemi filluar mirë, kemi pasur dy raste dhe është dashur t'i shfrytëzojmë rastet. Pas barazimit, ekipi bie dhe nuk është në nivel të asaj disiplinës taktike që jemi marrë vesh". Edhe ndeshja tjetër në mes të Trepçës '89 dhe Arbërisë përfundoi me rezultat 1-1. Pas njëzet minutave lojë, Anes Hoti e kaloi Arbërinë në epërsi. Vendasit nuk u ndaluan në kërkim të golit

### SUPERLIGA - Java 19

Feronikeli - Gjilani	1-1
Trepça '89 - Arbëria	1-1
Drita - Llapi	1-0
Prishtina - Drenica	3-1
Besa - Ballkani	0-3

Tabela		Pikë
1. Drita	19	44
2. Ballkani	19	41
3. Prishtina	19	35
4. Gjilani	19	30
5. Feronikeli	19	24
6. Arbëria	19	22
7. Trepça '89	19	22
8. Llapi	19	20
9. Drenica	19	19
10. Besa	19	6

Në xhiron e radhës takohen: Drita - Trepça '89, Drenica - Besa, Llapi - Gjilani, Arbëria - Prishtina, Ballkani - Feronikeli.

të barazimit dhe atë e arritën në minutën e 70-të, derisa shënues ishin Adenis Shala. Trepça '89 renditet në pozitën e shtatë me 22 pikë, kurse pikë të njëjta ka edhe Arbëria që renditet në një pozitë më lart.

### EPOKA ERE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 15 SHKURT** - Java e 19 në Superligën e Kosovës në futboll ka përfunduar të hënën me dy ndeshjet e fundit Feronikeli - Gjilani dhe Trepça '89 - Arbëria. Të dyja këto ndeshje përfunduan me rezultat të barabartë 1-1. "Ne dëshmuam edhe një herë se jemi skuadra më e mirë taktikisht në këtë kampionat. Nuk ka kush që na mposhtë, asnjë ekip, përveç njërit gjyqtarëve të ndeshjes. Pavarësisht se kam shumë respekt për gjyqtarin Dardan Çaka, ai me disa faulla e afroji Gjilanin deri te goli dhe mendoj se Gjilani nuk ka nevojë të ndihmohet sepse ka kualitet mjaftueshëm sa ta bëjë vetë këtë gjë. Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e skuadrës dhe të futbollistëve që dhanë

maksimumin për ta fituar këtë ndeshje. Bëmë gjithçka mirë, kontrolluam gjithë ndeshjen. Jam shumë i kënaqur me gjithë paraqitjen e skuadrës dhe gjithë futbollistët që dhanë maksimumin për ta fituar këtë ndeshje", ka thënë pas ndeshjes Klodian Duro, trajneri i Feronikelit. Në derbin e zhvilluar në Drenas në mes të Feronikelit dhe Gjilanit nuk pati fitues, pasi ndeshja përfundoi me rezultat 1-1, ani pse të dyja skuadrat patën mundësi që të merrnin fitore. Pas 20 minutave lojë, Adem Maliqi e kaloi skuadrën vendëse në epërsi 1-0. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll me këtë rezultat, derisa në fillim të pjesës së dytë mysafirët e barazuan rezultatin me golin e shënuar nga Muhamed Useini. Pas kësaj xhiroje, që është e para e sezonit pranveror, Gjilani renditet

## Zenelaj: Besojmë në kualifikim

**PRISHTINË, 15 SHKURT** - Për herë të parë të Kosova A janë ftuar Denis Zenelaj dhe Dion Sheqiri. Denisi luan për skuadrën Eisbaren Bremerhaven në Gjermani. Ai është shprehur shumë i kënaqur që është grumbulluar te Kosova. "Kemi filluar përgatitjet dhe deri më tani po shkojnë shumë mirë. Ne kemi shumë lojtarë të mirë dhe një trajner të mirë, andaj mendoj se gjasat janë shumë të mira



### ORARI

Më 18 shkurt takohen:  
16:00 Sllovakia-Islanda  
19:00 Kosova-Luksemburgu

Më 20 shkurt takohen:  
16:00 Luksemburgu-Islanda  
19:00 Kosova-Slovakia

për t'u kualifikuar tutje", është shprehur Zenelaj për faqen zyrtare të FBK-së.

18-vjeçari ka folur për ndjenjën për t'u grumbulluar te Kosova A. "Është një ndjenjë shumë e mirë, sepse kam punuar shumë për këtë ditë. Dua që në të ardhmen të jem pjesë e rregullt e Kosovës. Kam fituar shumë përvojë këtu. Më kanë pritur shumë mirë dhe jam tejmasë i kënaqur me të gjithë", ka thënë Zenelaj. "Dardanët" do të luajnë në shtëpi përballë Luksemburgut (18 shkurt) dhe

Sllovakisë (20 shkurt), në ndeshjet e fundit në Grupin B. Nëse "dardanët" shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. Të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B do të zhvillohen në Prishtinë. Ky ishte vendimi i mëhershëm nga Bordi i FIBA Evropës, duke i besuar edhe një ngjarje të rëndësishme Federatës së Basketbollit të Kosovës.

## Liga e Kampionëve rikthehet me superpërballjen Barça - PSG

**BARCELONË, 15 SHKURT (ER)** - Gati katër vjet pas "La Remontadas", Barcelona dhe Paris Saint-Germain do të përballen sonte (e martë) në ndeshjen e parë të raundit të 16-ave në Ligën e Kampionëve. Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, ka thënë se pret dy ndeshje interesante kundër skuadrës franceze, PSG. "E kemi pritur me shumë entuziazëm shortin. Pres dy ndeshje interesante dhe të bukura. Do të jetë një përballje e fortë, pasi dihet që PSG ka një ekip të fortë, por edhe ne jemi rritur shumë në muajt e fundit. Nuk e

di se si do të luajnë ata, mbetet për t'u parë në fushë. Ata janë një ekip që pëlqejnë të dominojnë në lojë, po ashtu edhe ne. Francezët do të kërkojnë të marrin një rezultat pozitiv, pasi luajnë në transfertë, por neve do të na pëlqente të merrnim një rezultat sa më të mirë", ka thënë Koeman. Të dyja këto klube do ta synojnë kalimin në çerekfinale, prandaj përballja në "Camp Nou" do të jetë mjaft interesante. Barça në fundjavë e



mposhti Alaveshin me rezultat bindës (5-1), kurse fitores i është gëzuar edhe PSG-ja ndaj Nicës (2-1). Mungesat e Barcelonës për këtë ndeshje janë Ansu Fati, Gerard Pique,

Philippe Coutinho dhe Sergi Roberto, derisa PSG-ja është pa Neymarin, Di Marian, Dagban, Pembelen dhe Bernatin. Trajneri i Paris Saint Germainit, Maurizio Pochettino, ka thënë se fokusi i PSG-së duhet të jetë në ndeshjen e Ligës së Kampionëve në Barcelonë. "Të gjitha ndeshjet janë të vështira. Unë mendoj se jemi kthyer nga një situatë e vështirë, me 10 ndeshje të luajtura në më pak se 40 ditë. Është e vështirë me të gjitha prob-

**TË MARTËN TAKOHEN:**  
Barcelona - Paris Saint-Germain  
RasenBallsport Leipzig - Liverpool

lemet që lidhen me Covid-19 dhe këtë periudhë mjaft të veçantë. Tani duhet të fokusohemi në ndeshjen e Ligës së Kampionëve në Barcelonë. Do të jetë e vështirë sepse do të luajmë edhe një herë një ekip shumë të mirë", ka thënë Pochettino. Të martën nga ora 21:00 zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Rasen Ballsport Leipzig dhe Liverpoolit.



## Fotis Takianos, trajner i KB Rahoveci

Rahovec, 15 shkurt - Skuadra e Superligës së Basketbollit, Rahoveci, e ka prezantuar trajnerin e ri Fotis Takianos. Trajneri grek do të jetë

pasardhës i Bujar Locit i cili është shkarkuar ditë më parë nga detyra e shefit të shtabit teknik për shkak të rezultateve jo të mira. "Tekniku me

përvojë shumëvjeçare, Takianos, do ta udhëheqë ekipin deri në fund të edicionit. Ai ka drejtuar skuadra të njohura në Evropë,

ndërsa kjo do të jetë aventura e dytë në Kosovë. Bashkë me të klubi synon të marrë rrugë të qartë drejt objektivave", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.



## Ismajli: Përballja me Ibrahimoviçin nuk ishte e lehtë

TIRANË, 15 SHKURT - Debutimi në Serinë A po shkon në mënyrën më të mirë të mundshme. Ardi Ismajli me Spezian arritën që t'i shkaktojnë Milanit humbje në transfertë (krahas Interit) që mungonte prej më shumë se një viti, që nga nëntori 2019. Në ndeshjen e vlefshme për javën e 22-të, mbrojtësi i Kombëtares ishte perfekt në çdo ndërhyrje duke detyruar që Ibrahimoviçi të mos bënte asnjë gjuajtje në kuadrat. Për "Panorama Sport", Ismajli ka komentuar fitoren ndaj Milanit, mënyrën e lojës dhe përgatitjen për ndeshjen me kryesuesit e kampionatit. Ndër të tjera, 24-vjeçari komenton edhe shortin e Kombëtares. Për shqiptarin, sfida ka qenë speciale. "Panorama Sport" mëson ekskluzivisht se ka pasur skautë nga Dortmund e Marsejë që kanë mbajtur shënime për lojën e tij. Mbrojtësi është në edicionin e tij të parë në Serinë A dhe emocionet janë të mëdha. "Jam në vitin tim të parë në Serinë A dhe për mua jo




vetëm kjo fitore ndaj Milanit, por çdo ndeshje që zhvilloj, është me emocione të mëdha. Sigurisht, që sfida si kjo me skuadra të mëdha janë speciale dhe është mrekulli të dalësh me tri pikë", ka thënë fillimisht për gazetën qendërmbrojtësi i Spezias. Për qendërmbrojtësin e Kombëtares, kjo ishte ndeshja e gjashtë në Serinë A dhe e treta të cilën e nisi si titullar. Përballë kishte një "bishë" si Zlatan Ibrahimoviç, por ia doli. "Ishte shumë e vështirë. Ibra është një lojtar klasi, ka forcë, ka cilësi, ka përdorim topi si dhe ka zgjuars

në leximin e lojës, ndaj sfida përballë tij ishte shumë e vështirë. Në fakt, patëm disa momente diskutimi për episode të caktuara të ndeshjes, por asgjë përtej normave të profesionalizmit ku secili prej nesh shprehte pretendimet e veta për rastin në fjalë. Ne në çdo ndeshje futemi me presing maksimal, për të mos lënë asnjë ekip të na rrezikojë. Këtë na kërkoi trajneri dhe ndaj Milanit, fituam dhe na falënderoi të gjithëve", ka thënë Ismajli për "Panorama Sport".

## Lakersat bien ndaj Denverit, Portlandi mposhti Dallasin

Los Anxhelos, 15 shkurt - Kampionët në fuqi të NBA-s, Los Angeles Lakers, u ndalën sërish, pasi u mposhtën me rezultatin 122-105 në transfertën ndaj Denver Nuggetsit në "Ball Arena". Me grekun Kostas Antetokounmpo të dëmtuar dhe Anthony Davies e LeBron Jamesin larg formës më të mirë, Lakersat e patën të vështirë të përballen me Denverin. Të udhëhequr nga forma mjaft e mirë e serbit Jokiç dhe amerikanit Murray, Nuggets mori kontrollin e lojës që në fraksionin e dytë, të cilin e fitoi thellë dhe më pas vijoi ta mbajë kryesimin deri në fund. E nëse Lakersat ndalen, nuk ndodh e njëjta gjë me Clippersat, që morën fitoren e tretë radhazi, këtë herë me shifrat 128-111 ndaj Cleveland Cavaliersit në "Staples Center" të Kalifornisë. Lou Williams ishte protagonist absolut për skuadrën kaliforniane, pasi shënoi 30 pikë,



rikuperoi dy topa dhe dha 10 asistime, ndërsa Caviu u zgjua vetëm në fraksionin e fundit falë një loje të mirë të Sextonit, por kjo nuk mjaftoi që ta shmangin humbjen. Slloveni Luka Donçiq ishte në një formë fantastike dhe arriti të shënojë 44 pikë, të rikuperojë 7 topa e të japë 9 asistime në "American Airlines Center" të Dallasit, por kjo nuk i mjaftoi Mavericksit ta shmangë humbjen përballë Portland Trail Blazersit. Ky i fundit, i udhëhequr

nga Lillardit, fitoi me rezultat të thellë fraksionin e parë e të tretë të lojës dhe ndonëse humbi dy pjesët e tjera, ia doli të largohet si triumfator nga Dallasi. Në sfidat e tjera San Antonio Spursi triumfoi me shifrat 110-122 në transfertën ndaj Charlotte Hornetsit, Detroit Pistonsi mposhti New Orleans Pelicansin me shifrat 123-112 dhe Oklahoma City Thunderi fitoi me shifrat 114-109 ndaj Milwaukee Bucksit.

### SHKURT

#### Januzaj: Nuk kam pse t'ia dëshmoj Unitedit sa i mirë jam

Futbollisti me prejardhje shqiptare, Adnan Januzaj, thotë se nuk do të ndiejë motivim shtesë kur të dalë përballë ish-klubit të tij, Manchester Unitedit, në Ligën e Evropës këtë të enjte. Ylli i Sociedadit ka këmbëngulur se ai nuk ka nevojë t'ia dëshmojë askujt sa çfarë futbollisti është. "Nuk kam pse t'ia dëshmoj askujt sesa i mirë jam. Thjesht duhet të besoj në veten, të luaj dhe të jem i lumtur. Jam i lumtur që po rikthehem atje, në klubin që e dua. Por, kur të futem në fushë, nuk do të ketë miqësi, sepse unë luaj për një klub tjetër tani dhe dua të fitoj po ashtu", ka thënë Januzaj në "ESPN". Januzaj u transferua te skuadra baskë në vitin 2017 nga "Djajtë e Kuq", teksa karrierë ka bërë edhe te Sunderlandi.

#### Domenicali: Formula 1 do ta ndjekë modelin e NBA-së

Stefano Domenicali, ish-drejtori sportiv i Ferrarit, ka një plan të qartë se si do të ndryshojë këtë sport, për ta bërë atë më tërheqës dhe për t'i kaluar vështirësitë e pandemisë Covid-19. "Formula 1 duhet të dalë mbi vështirësitë, duhet të ofrojë një sfidë teknologjike të dominuar nga pilotët-heronj, që përfaqësojnë vlera universale dhe që janë të pëlqyer nga të gjithë", ka thënë Domenicali për mediat italiane. Ai pranoi se Formula 1 do ta imitojë modelin e ofruar nga NBA-ja, duke e bërë sportin e automobilizimit një miks mes ekipesh legjendare dhe pilotësh kampionë. "E njoh komisionarin e NBA-së, Adam Silver dhe së shpejti do të takohem me të për t'i ndarë idetë. Dhe jo vetëm me atë. Duhet ta tërheqim vëmendjen e publikut, duke korigjuar disi formatin. Do të aplikojmë të shtunën garat sprint, që do ta përcaktojnë startin e garës së të dielës", ka shtuar Domenicali.

#### Guardiola: Ederson është më i mirë se Neueri dhe Valdesi

Manchester City këtë sezon është në formë të frikshme dhe po shkëlqen në të gjitha aspektet. Një portier i mirë është më shumë se nevojë dhe Pep Guardiola duket se ka goditur në shenjë me Edersonin. Brazili është "mace" mes katërkëndëshit dhe shkëlqen në atë që Guardiola e ka aq merak, lojën me këmbë. Spanjoli në një intervistë të dhënë së fundmi thekson se Ederson është më i mirë se Manuel Neuer dhe Viktor Valdes në lojën me këmbë. "Edersoni me këmbë është më i miri, cilësia e tij e pasimit është pa dyshim më e mira. Manuel Neueri dhe Victor Valdes ishin gjithashtu të jashtëzakonshëm, por Edersoni ka cilësitë më të mira në pasim. Gjithsesi, nuk mund të them se cili është portieri më i mirë në botë", ka thënë Guardiola.

#### Interi rikthen interesimin për Fekirin

Skuadra e Interit e ka rikthyer interesin për Nabil Fekir, i cili po bën një sezon shumë të mirë me Betisin nën urdhrat e Pellegrinit. 27-vjeçari mund të luajë në rolin e organizatorit, por edhe anësorin në skemat e trajnerit italian ndaj dhe zikaltrit duan ta afrojnë. Megjithatë, pandemia ka lënë pasojat e saj në financat e zikalterve, që do të provojnë ta marrin francezin në këmbim të mesfushorit Matias Vecino, i cili sapo është kthyer nga një dëmtim dhe nuk bën pjesë në planet e trajnerit Conte.

## Juve me katër mungesa ndaj Portos

Humbja ndaj Napolit ka lënë pasojat edhe më të mëdha te Juventusit. "Bardhezinjtë" do të luajnë në mesjavë kundër Portos, por do të

kenë disa mungesa. Juan Cuadrado pritet të jetë një nga mungesat e mëdha, pas një dëmtimi që pësoi në pjesën e parë ndaj të kaltërve.

Mesfushori ditën e sotme u është nënshtruar testeve mjekësore dhe pritet të mungojë në dy sfidat e ardhshme të bardhezinjve, ato me

Porton dhe Crotonen. Ndërkohë, mungesa të tjera për trajnerin Pirlo në takimin e Ligës së Kampionëve priten të jenë edhe Arthur, Paulo

Dybala dhe Aaron Ramsey. Lajm i mirë për "Zonjën e Vjetër" është se kundër portugezëve do të rikthehet Bonucci, i cili mungoi në fundjavë.



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €




Daut Dauti  
•  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë







## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



## K O N K U R S

**Pozita e punës, Konduktor/e**

Numri i pozitave: 85 (tetëdhjetë e pesë)

**Kohëzgjatja e punës:** 1 vit.

**Shënim:** Kohëzgjatja e kontratës varet ekskluzivisht nga politika e inkasimit të biletave në ndërmarrje. Nëse ndërmarra vendosë për biletim elektronik, atëherë automatikisht do të shkëputen dhe kontratat e punës.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kujdeset për hyrje dhe dalje të udhëtarëve në çdo stacion për autobusët e NPK "Trafikut Urban"SHA.
- Furnizon udhëtarëve me kupon fiskal në kohë dhe me rregull;
- Të ketë sjellje korrekte me udhëtarë.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

1. Të ketë të kryer së paku shkollën e mesme;
2. Përvoja e punës si konduktor/e është obligative së paku 3 muaj;
3. Kandidati/ja duhet të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë në punë.
4. Kandidati/ja duhet të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës;
5. Të jetë komunikativ me qytetarë

**Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com):

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
2. Dëshmi mbi shkollimin;
3. Kopja e letërnjoftimit;
5. Dëshmi të përvojës së punës;
6. Dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetimi jo më të vjetër se 6 muaj.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **16.02.2021** dhe përfundon më datë **02.03.2021** në ora 24:00

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## Lume's Details

### Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besnik Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.

► Fitim Saramat shpall të pavlefshme diplomën shmit "11 Marsi " Prizren.

► Selim Muharemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Edit Durham " Mushtishte.

► Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

